



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 90
Prishtinë, më 26.6.2024, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca dhe Doarsa Kica-Xhelili.

Munguan: Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu- Shoshi, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

I pranishëm në takim: Kristo Enn Vaga, kryetar i Grupit të Miqësisë Estoni-Kosovë në Parlamentin e Estonisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Leudita Mejzini, Adriana Osmani, Albana Baraliu, Kuvend.

Nga Zyra e Komisionit: Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim me z. Kristo Enn Vaga, kryetar i Grupit të Miqësisë Estoni-Kosovë në Parlamentin e Estonisë.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, falënderoi z. Kristo Enn Vaga për vizitën dhe takimin, për të diskutuar lidhur me çështje të rëndësishme në mes të dy vendeve. Duke pasur parasysh situatën gjeopolitike në Evropë, tha se ne e shohim të nevojshme të qëndrojmë bashkë për të mbajtur njëri- tjetrin më shumë se kurrë më parë dhe pas invazionit të Rusisë në Ukrainë, BE është kërcënuar nga ky invazion dhe është e pasigurtë gjatë këtyre dy viteve, situatë kjo e cila ka mundësi që të shpërndalet. Ne jemi shumë me fat që Kosova e Estonia kanë marrëdhënie të shkëlqyera mes vete dhe ky raport do të rritet e fuqizohet në të ardhmen. Estonia e ka mbështetur Kosovën në shumë procese ndërkombëtare, që ka kaluar vendi ynë dhe besojmë se kjo mbështetje do të vazhdojë edhe për anëtarësimin e Kosovës në NATO.

Kristo Enn Vaga, falënderoi për ftesën, duke shtuar se është i nderuar që gjendet si i ftuar për vizitë në Kosovë. Ai tha se ne jemi duke parë se çfarë është duke ndodhur jo larg kufijve të tyre dhe duke parë se këto diktatura kanë një bashkëpunim të shkëlqyer në mes tyre. Theksoi se nga ana politike estoneze, e sheh propagandën enorme të vazhdueshme në Serbi dhe gjatë konfliktit në pjesën veriore të Kosovës janë parë municione e vetura ruse, të cilat janë përdorur e që paraqesin një problem për ne e po ashtu kemi parë diktatorët duke bashkëpunuar, por edhe ne si demokraci duhet të bashkëpunojmë. Në skenën politike në Estoni, tha se është duke u rritur të kuptuarit e rëndësisë për Ballkanin Perëndimor dhe Kosovën. Ne duhet të forcojmë edhe më tepër lidhjet tona me Kosovën dhe kompanitë estoneze janë të interesuara për tregun në Kosovë, sepse Kosova është një demokraci e cila rritet me shpejtësi marramendëse. Në sferën politike, theksoi se janë përpjekur që ta ndihmojnë Kosovën, aq sa kanë pasur mundësi. Nga perspektiva e tij, tha se Kosova është sanksionuar pa asnjë arsye, ndërsa Serbia nuk është sanksionuar fare dhe kjo qasje duhet të ndryshojë. Pyeti anëtarët e Komisionit: cilat fusha i shohin të mundshme për bashkëpunim në mes të dy vendeve, a është e nevojshme kampanja për KiE, qeverisja digjitale apo ndonjë fushë tjetër, ku Estonia mund të ndihmojë?

Xhavit Haliti, falënderoi z. Kristo Enn Vaga për vizitën, për të cilin tha se vjen nga një vend me një përvojë mjaft të madhe e mjaft dramatike, historikisht. Shkëputja e Estonisë nga BRSS ka qenë një gëzim dhe një revolucion i madh në Evropën e atëhershme, por edhe një kontribut për Evropën e bashkuar. Bëri të ditur se në Kosovë, të gjitha partitë politike kanë orientim pro-perëndimor, edhe pse ndonjëherë dallimet në disa çështje politike janë të natyrave të ndryshme, por kur është fjala për çështje të rëndësishme të avancimit të pozitës së Kosovës, ne kemi nevojë për miq, duke përfshirë edhe planet e projektet tona, të Evropës e Amerikës, që të bëhemi pjesë e OKB-së. Sa i përket investimeve, theksoi se është e domosdoshme që të studiohen ligjet në Kosovë. Këtu, investitorët e juaj do të kenë një ambient mik, kemi moshën e re të qytetarëve që kanë nevojë për punë, legjislacionin, sigurinë e nivelit maksimal, përshtatshmërinë në çështje tatimore, nuk ka afera korruptive tek investimet e huaja dhe kemi gatishmërinë e Kosovës që të bëhet oazë e investimeve nga jashtë.

Doarsa Kica-Xhelili, sa i përket çështjes së investimeve të huaja, njoftoi se Kosova në fushën e IT-së ka filluar të bëhet prijëse në rajon dhe kemi biznese të cilat janë duke i përdorur shërbimet tona dhe janë bërë storie e suksesit. Bëri të ditur se janë dy apo tri kompani të IT-së, të cilat do të duhej të vizitohen patjetër, të cilat janë me plot njerëz të rinj dhe sipas statistikave, vetëm sektori i IT-së është duke punësuar në Kosovë rreth 40.000 njerëz. Ajo kërkoi që çfarëdo mundësie që do të ketë z. Kristo Enn Vaga, të tregojë realitetin e Kosovës për investitorët potencialë, sepse do të ishte një gjë shumë e dobishme dhe ndihmë e madhe për ne.

Kristo Enn Vaga, theksoi se në Kosovë është duke u bërë ndryshim i madh edhe në sektorin e energjisë së ripërtëritshme dhe sipas standardeve të BE-së. Storie e suksesit e Estonisë është se për kokë banori ka më së shumti kompani të IT-së, ka ndërtuar “SKYPE” para 20 viteve dhe është bërë transformim i madh digjital. Z. Kristo Enn Vaga, theksoi se për vizitën e radhës në Kosovë, deri në fund të këtij viti, mund të sigurojë disa komani, si pjesë të delegacionit të tij, nga i cili takim tha se mund të dalin çështje specifike për bashkëpunim.

Yllza Hoti, sa i përket investimeve të huaja në Kosovë, tha se në sektorin e ICT, kemi potencial të madh dhe numër të madh të rinjve nën moshën 30- vjeçare, nga të cilët shumica flasin gjuhën gjermane apo angleze, gjë që na mundëson të bëhemi pjesë e tregut global. Tani kemi liberalizimin e vizave që është një lehtësim i madh për ndërmarrësit dhe për kontakte. Ajo kërkoi që të vazhdojë bashkëpunimi, të krijohet një urë lidhëse në mes të ndërmarrësve në Estoni dhe në Kosovë, nga i cili kontakt mund të mësojnë shumë njerëz të rinj në sfera të ndryshme të shoqërisë. Njoftoi se kemi një sistem e-Kosova

dhe se ofrohen shumë shërbime të reja online nga vendi ynë, shërbime publike të cilat janë të qasshme online. Ky është një sistem i ri, i cili ende ka hapësirë për përmirësime.

Kristo Enn Vaga, njoftoi se sa i përket sistemit të tyre të e-qeverisjes, është një sistem shumë i rëndësishëm dhe shumë lehtë për të funksionuar online. Në Estoni, 99% të shërbimeve publike janë online dhe i vetmi shërbim që nuk mund të bëhet online është shkurorezimi. Njoftoi se kanë votimin elektronik, që është shumë i rëndësishëm, i cili mund të gjejë vend edhe në Kosovë, meqë Kosova ka një diasporë shumë të madhe në mbarë botën, që marrin pjesë në zgjedhjet demokratike. Sa i përket dialogut, pyeti: cilat janë pikat kryesore, të cilat duhet t'i përdorin, që t'i bindin miqtë tanë ndërkombëtarë që Kosova është duke e bërë gjënë e duhur?

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, theksoi se anëtarësimi në NATO, është prioritet për Kosovën, për të cilën çështje edhe Estonia mund të na ndihmojë përmes lobimit. Anëtarësimi në KiE është një nga prioritet tona. Kosova ende është nën sanksione nga BE dhe shpresojmë se shumë shpejt do të merret vendimi për largimin e këtyre masave, dhe sa më shumë zëra që kemi në favorin tonë, mundësia është më e madhe t'ju tregojmë të tjerëve se ne kemi të drejtë dhe ishin në gabim, kur e kanë marrë këtë vendim për Kosovën.

Xhavit Haliti, kërkoi të njoftohet nga z. Kristo Enn Vaga, se si aplikohet votimi elektronik nga diaspora, por edhe nga qytetarët të cilët dëshirojnë të votojnë nga shtëpia.

Kristo Enn Vaga, njoftoi se në Estoni kanë një hapësirë të madhe për t'iu shpjeguar mysafirëve ndërkombëtarë infrastrukturën e e-qeverisjes. Sa i përket mënyrës së sistemit të votimit online, njoftoi se çdo estonez e ka një çelës, me të cilin identifikohen, kanë kartela të identifikimit dhe një çip, të cilin e vendosin në kompjuterin e tyre dhe një pin kod, përmes të cilit identifikohen në sistem, që është personi i caktuar. Votuesi duhet të shkarkojë programin shtetëror, të identifikohet me ID-kartelë dhe të votojë.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu- Hyseni,

Kryetare e Komisionit